



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1479/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj – Sheremeti, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit G... sh.p.k me seli ne Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.Sh avokat në Prishtinë, kundër kundërshtarit të sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.R avokat në Prishtinë, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së përkohshme te sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.784/2021, i datës 26.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.**13/09/2022**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** ankesa e propozuesit të masës së përkohshme te sigurisë G... sh.p.k me seli ne Prishtinë dhe **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.784/2021, i datës 26.01.2022 dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Gjykatës Komerçiale, Dhomës se Shkallës se Parë.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propozimin e propozuesit të sigurimit te masës se sigurimit G... sh.p.k me seli ne Prishtinë, lidhur me caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren, me të cilën ka kërkuar që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren qe ta perdore markën tregtare – llogon e paditësit, deri ne përfundimin e çështjes kryesore vendim te plotfuqishëm.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i propozuesit të masës së perkoheshme te sigurimit, G... sh.p.k me seli ne Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që i njëjti të ndryshohet ashtu që propozimi i caktimit të masës së sigurisë të aprovohet ose të priset ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kundërshtari masës sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e palës propozuese dhe të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë III.EK.nr.784/2021, i datës 26.01.2022.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

#### **-Ankesa është e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë G... sh.p.k me seli ne Prishtinë, me datën 03.12.2021 pranë gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren, duke i propozuar gjykatës që ta aprovohet propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit me te cilën i ndalohet kundërshtarit te sigurimit S... sh.p.k me seli ne Prizren qe te perdore markën tregtare – llogon e paditësit

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme te sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, si të pabazuar, duke vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, e që përbejnë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdhë në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare.

Nga shkresat e lendes rezulton se pala propozuese ne parashtresën e datës 03.12.2021, i ka propozuar gjykatës caktimin e masës se përkohshme siguruese, derisa gjykata ne kundërshtim me nenin 306 te LPK-se, fillimisht me date 07.12.2021 ka nxjerre njoftim te cilin i ka dërguar kundërshtarit te sigurimit, duke e njoftuar për pretendimet e propozuesit, e po ashtu ne kundërshtim me kete dispozite ka caktuar seancën dëgjimore (duke e emërtuar seanca e shqyrtimit përgatitore), gjykata e shkalles se pare ne kundërshtim me kete dispozite ligjore (nenin 306 te LPK) merr aktvendim me te cilin vendos qe te refuzoj masën siguruese, përkundër faktit se propozimi i propozuesit si ne parashtresën e datës 03.12.2021 ishte për masën e përkohshme siguruese. Nga kjo

rezulton se gjykata e shkalles se parë fare nuk ka bere dallimin ne mes te masës siguruese dhe masës se përkohshme siguruese.

Gjykata e shkalles se dyte, konstaton se edhe parashtrësja, përkatësisht, propozimi i propozuesit te masës se përkohshme te sigurimit (petitumi) është i paqarte dhe i mangët dhe si i tille duhet te plotesohet nen kercnim te lëshimit, ne kuptim te nenit 102 te LPK-se.

Po ashtu gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes, ne arsyetimin e aktvendimit te atakuar, gabimisht ka konstatuar se aprovimi eventual i propozimit te propozuesit do te perbente paragjykim. Konstatimi i tiile i gjykatës eshte ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit per Marka Tregtare (si ligjit i cili ka qene ne fuqi ne kohen ndodhjes se shkeljes se pretenduar, ashtu edhe ligjit i cili ka hyre ne fuqi ne muajin korrik 2022), pasi ligji përcakton mundësin qe gjykata të urdhëroj shkelësin e supozuar që t'i ndalojë dhe t'i ndërpresë veprimet që shkelin markën tregtare.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara dhe në ri procedurë duhet të eliminohen te gjitha shkeljet e lartëtheksuara si dhe të vlerësoj të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve dhe pastaj të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 209 paragrafi 1 pika (d) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,  
Kom.Dh.Shk.II.nr.1479/2022, dt.13.09.2022**

**KRYETARI I KOLEGJIT,  
Faton Bajrami, d.v**